

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qeveria u kërkoi fitimin e fshehur/ Pse e refuzuan Ramën tregtarët e ushqimeve
ADRESA	https://lapsi.al/qeveria-u-kerkoi-fitimin-e-fshehur-pse-e-refuzuan-ramen-tregtare-e-ushqimeve-i1094089
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 15:32:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 15:26:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e04a34aa2205f9038fbf8fb780f41c433ade4eec696b3df7ffe42138cdb29bd7
TEKSTI	3a7ba54d507f1029975c07fbd727c36bd09568f8737d0283657f63ad0f6f1d25
PAMJA	3af22083077c2be5374a6aef609bdc6007b304ce6c385a8abfd6db4b4fb6702e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	492ad79427ba4af7279c6c6b502c92f09b0b2ce1ee98478cd573b6479827dca5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	27cd3d5362ad8606db4b4a4bb83953e8ab924c30f9fa24532364779df926f41e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/492ad79427ba4af7279c6c6b502c92f09b0b2ce1ee98478cd573b6479827dca5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Qeveria u kërkoi fitimin e fshehur/ Pse e refuzuan Ramën tregtarët e ushqimeve

LAPS1.AL • 20 SEPTEMBER 2026



Nga Dorian Kodra

Të premten në mesditë, në një nga sallat e kryeministrit ishin ftuar pronarët e supermarketeve, që prej dy javësh kishin refuzuar t'i dorëzonin qeverisë një liste me çmimet e mallrave që shesin në dyqanet e tyre.

Me buzët e rrudhura, vetullat e mbledhura dhe me pamjen e njeriut që e kishte gdhirë gjithë natën duke menduar për çmimin e bukës dhe të vezës, Edi Rama hyri i pari në sallën ku e prisnin tregtarët. Përballë tij, pronarët rrinin seriozë e të heshtur dhe, për disa çaste, skena të sillte ndër mend më shumë një mbledhje të komisarëve me fshatarët të filmi "Përballimi", se sa një takim të qeverisë me biznesin në një ekonomi të tregut.

Sigurisht që përballë Ramës nuk ishin kulakët që fshihnin thasët me grurë. Ai as nuk i quajti "shushunja" siç bënin në prodhimet e Kinostudios së re, por gjuha që përdori kryeministri ishte e ngjashme. Sipas tij po jetojmë në një "kapitalizëm agresiv", aty ku tregtarët po fitonin "më shumë se sa ç'e mban zakoni i mirë"; ai i paralajmëroi se qeveria nuk do t'i lejonte "që të ngarkoni njerëzit" me çmime të rënda dhe ua bëri të qartë se mund të vinte dita kur të thoshin: "Çfarë i hapëm vetes? Në djall ato që po i fitojmë pa të drejtë..."

Përkrah Ramës ishin shoqe Delina, ministre e ekonomisë që u tha pronarëve se përgatitja e listës së çmimeve nuk shkonte më shumë se një orë punë, dhe shoku Petrit, ministër i financave që u shpjegoi se qeveria kërkonte të gjente një hallkë në zinxhirin e furnizimit, ku çmimi fryhej abuzivisht. Mungonte aty vetëm "shoku Martin"...



ide



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes manizmi

Andi Bushati



Gënjeshtër e rezortëve elitare

Blendi Kajsia

MOTITIRANA

26°C

KËMBIMIEURO

91.54

aktuale

19:34

Protesta e 112-të në Tiranë, protestuesit kërkojnë ndryshim të Kodit Zgjedhor

09:44



U ndaluan pas tensioneve në tubimin e djeshëm, lironen 25 të ndaluarit



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku





RAMA DUKE FOLUR NË TAKIM ME PRONARËT E SUPERMARKETEVE

Nisma e qeverisë synon krijimin e platformës “Pasqyra e Çmimeve”, një model i aplikuar më parë në Greqi dhe në Itali për të mbajtur nën kontroll çmimet e ushqimeve bazë. Transparenca shihet si një masë që mund të rrisë konkurrencën dhe të pasohet me ulje çmimesh.

Edhe Greqia dhe Italia përdorën marrëveshje me supermarketet për të frenuar çmimet. Vetëm se qeveritë atje nuk ia nisën duke mbledhur tregtarët në një sallë për t’u bërë presion se pse fitonin kaq shumë.

Si në Greqi, ashtu edhe në Itali, shumë ushqime bazë tatonen me TVSH të reduktuar. Në Greqi norma standarde e TVSH-së është 24%, por për bukën, qumështin, mishin, peshkun, vajin e ullirit, djathin, makaronat, miellin, drithërat dhe perimet zbatohet norma e reduktuar 13%.

Italia gjithashtu aplikon prej kohësh norma të reduktuara të TVSH-së për kategori të ndryshme ushqimore.

Të dyja qeveritë, në Greqi dhe në Itali nxorën gjithashtu para nga buxheti për të zbutur faturën e ushqimeve të familjeve.

Italia krijoi kartën “**Dedicata a te**”: në vitin 2023 vuri fillimisht 500 milionë euro në dispozicion të rreth 1.3 milionë familjeve në vështirësi për blerjen e ushqimeve bazë; fondi u rrit më pas në 600 milionë euro. Greqia krijoi “**Market Pass**”, që në fazën fillestare subvenciononte 10% të një shume mujore të llogaritur për blerjet ushqimore, duke nisur nga 22 euro ndihmë në muaj për një familje me një person dhe duke u rritur sipas numrit të anëtarëve. Ndihma jepet në formë një karte dixhitale ose, më një shumë



1 Kush është Artan Myrtaj që u ekzekutua ditën e sotme, viktimja njëhej si 'Tani Ruzhdiut'



2
Burri vret me thikë gruan teksa kujdesej për 2 nipërit, 68-vjeçari ishte arrestuar edhe më parë për dhunë në familje



3
Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar



4
Gemini hakon tri kompani, ngrihen pikëpyetje për sigurinë e AI-së

shpesh namnit të anëtarëve. Namna jepen për mos një kur të diamantë 500, me një shuma 20% më të ulët, drejtpërdrejt në llogarinë bankare.

Në të dyja rastet qeveritë përdorën edhe paratë dhe instrumentet e shtetit, përpara ose paralelisht me presionin ndaj tregtarëve.

Ndërsa në Shqipëri, teksa Rama u kërkon tregtarëve të heqin dorë nga një pjesë e fitimit, qeveria vazhdon ta mbajë TVSH-në standarde, 20% për ushqimet bazë.

Dikur Rama e mendonte ndryshe zgjidhjen për familjet e varfra. Me premtimin "zero TVSH për ushqimet" ai erdhi në pushtet. Atëherë argumentonte se si një familje nuk duhej të paguante 20% taksë mbi bukën, qumështin, vezët, miellin apo orizin. Shiko videon më poshtë:



Tani që çmimet e ushqimeve në Shqipëri kanë tejkaluar mesataren e Bashkimit Europian, qeveria po e kërkon me çdo kusht fajtorin brenda supermarketit. Vetëm se ky zell për t'ia lënë tregtarëve fajin nuk duket të jetë i ndershëm.

Prandaj dhe skenat që krijohen në kryeministri ngjanin te filmi "Përballimi", atje ku Kadri Roshi lëshoi me mjeshtëri batutën, që keto dy javë e kanë pasur në mendje pronarët e supermarketeve: "Gërmo Tare, gërmo, aty kam qenin e ngordhur! Merre, Merre!" /Lapsi.al

Të këshilluara



Saranda nën terror/ Drejtori i policisë në Rinas, si figurant në videon e ministrit të ri

Vrasja e Artan Myrtajt paraditen e kësaj të diele në qendër të Sarandës është pjesë e një konflikti të n...



Bilanci i presidencës Begaj/ Gjenerali që u shkri si sheqeri

Ka nxituar të dekretojë në mëngjes një ligj të votuar në mesnatë. Po kjo nuk është shkeja e parë mbi reputacionin e postit që bën Bajram Begaj. Një retrospektivë katër vjecare e presidencës së tij






Gjykata ndërkombëtare bllokon qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyt SPAK për aeroportin e Vlorës



Revolta në Prishtinë, kënaqësi në Beograd/ Si u prit dënimi me burg për ish-krerët e UÇK-së

Vendimi i Gjykatës Speciale për të dënuar me gjithsej 81 vite burg katër ish-drejtnesit kryesorë të Ushtrisë Çli...



Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së

Gjykata Speciale dënoi Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burg, Kadri Veselin me 18 dhe Rexhep Selimin me 13, pasi i shpalli fajtorë për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje si krime lufte, ndërsa rrëzoi akuzat ndaj tyre për krime kundër njerëzimit.



Trafiku i drogës, korrupsioni dhe projekti i Kushner, seancë dëgjimore në Kongresin amerikan, DASH mbështet SPAK

"Organizatet kriminale transnacionale që veprojnë në Shqipëri kanë lidhje me kartelat e drogës në Hemisferën Perëndimore"



"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ The New Yorker: Si u hapën dyert për Kushnerin



Veliaj mbetet në burg/ Gjykata e Lartë e sheh si proporcional izolimin e tij?

Çdo të bëhet me qytetarët e Tiranës tani që psi për arsye të procesit Veliaj e futi Bashkinë në kaos. A do të vijojë të këmbëngulë ai që mos e delegojë sërish autoritetin dhe firmën dhe të shtirret si kryetar nga burgu?



Zgjerohet skandali i izraelitit Ron Yeffet, nëraimi: Shkoni në Vlorë dhe bëni cfarë të



doni”

“Shkoni në Vlorë dhe shikoni, bëni çfarë të doni, më pas do të merrem unë me ta” është fja...



Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"

Pas muajsh heshtjeje dhe mbrojtjeje politike, sinjalet nga mediat pranë qeverisë dhe qëndrimi i ri i Edi Ramës tregojnë se Belinda Balluku mund të jetë lënë tashmë vetëm përballë SPAK-ut, në prag të një kërkesë të dytë për arrestimin e saj.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.